



Funded by  
the European Union



Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Komunës së Vushtrrisë dhe të Projektit ReLOaD3 (Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 3), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), shpallim këtë:

## **NJOFTIM PUBLIK PËR OJQ-të**

### **Sesionet Mentoruese**

#### **në kuadër të**

#### **Thirrjes së Parë Publike për Projekt Propozime për OSHC-të në Komunën e Vushtrrisë**

Me datë **16 (e hënë), dhe 17 mars (e martë), 2026**, me fillim nga **ora 10:00**, Komuna e Vushtrrisë, në bashkëpunim me UNDP-në dhe Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3), organizon **sesione mentoruese** për OSHC-të e interesuara të përgatisin projekt-propozimet dhe/ose të aplikojnë në Thirrjen e Parë Publike për dorëzimin e projekt-propozimeve nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të), në përputhje me kriteret dhe prioritetet e përcaktuara bashkërisht.

Sesionet mentoruese do të realizohen nga ora **10:00 deri në ora 15:30**, dhe do të zhvillohen në **Sallën e Asamblesë Komunale** në Vushtri.

**Shënim:** Për sesionet mentoruese lidhur me projekt propozimet, rekomandohet që OSHC-të të sjellin laptop-in personal, për lehtësimin e marrjes së shënimeve dhe adresimin e rekomandimeve gjatë sesionit.

Ju mirëpresim!